

SHËNIME SHPJEGUESE PËR DEKLARIMET FINANCIARE TË VITIT 2018

1. ORGANIZIMI, OBJEKTI DHE KONTRIBUTET

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "KASSEL" është krijuar në QKB, më datë 05.06.2012, në Tiranë. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit Nr.9901 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", datë 14.04.2008 dhe Statuti i shoqërisë.

Shoqëria "KASSEL", është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me një ortak të vetëm që zotëron 100% të kapitalit, numri i përgjithshëm i kuotave është 1.

Kapitali aksionar është 214.880.000 lekë.

Selia e shoqërisë është në adresën: Rr. "Sami Frasheri", Nd.56, Hyrja Nr.36, Ap.13, Kodi Postar 1019, Njësia Administrative Nr.5, Tiranë .

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është ndërtimi në formën më të gjerë, shërbimet e skelerisë si dhe prodhimi i produkteve metalike.

Kontributet e saj janë teresisht të ortakut të vetëm të shoqërisë.

Aktivet janë në vlerën prej 340.234.368 lekë.

Pasivet janë në vlerën prej 340.234.368 lekë, nga të cilat Detyrimet zënë vlerën prej 118.085.325 lekë dhe Kapitali zë vlerën prej 222.149.043 lekë.

2. POLITIKAT DHE RREGULLAT KRYESORE KONTABILE

a) Të përgjithshme

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet e tyre materiale në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit, (Standarti kombëtar i kontabilitetit nr.2, Përgatitja dhe Paraqitja e Pasqyrave Financiare) dhe me kërkesat e Ligjit Nr.9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i ndryshuar.

Në deklaratimet financiare janë respektuar politikat kryesore kontabile:

Vlerësimi i Aktiveve Afatgjata Materiale, Aktiveve të Tjera Financiare Afatgjata dhe Aktiveve Afatshkurtra. Ky vlerësim është bërë në përputhje me kërkesat e Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit.

Është ruajtur paprekshmëria e bilancit të çeljes. Pasqyrimi i veprimeve financiare është mbështetur në dokumenta justifikues, etj. Deklarimet financiare janë shprehur në lekë.

b) Vlerësimi i Stoqueve (Gjendjet e Inventarit)

Vlerësimi i gjendjes inventariale është bërë me koston e blerjes.

c) Dokumentimi

Rregjistrimi i të gjithë transaksioneve në librat kontabël është mbështetur në dokumenta justifikues të cilët përmbushin kriteret ligjore, pra me to vërtetohet pronësia dhe justifikohet qëllimi e domosdoshmëria.

d) Sistemi Kontabël

Kontabiliteti mbahet në mënyrë të informatizuar me ndihmën e programit financiar Financa 5.0. Mënyra e organizimit të sistemit mundëson:

- Identifikimin dhe evidencimin e operacioneve ekonomike.
- Përshkrimin e saktë të operacioneve ekonomike, të cilat japin mundësinë e klasifikimit të rregullt për të përpiluar informacionet financiare.

TP



- Kontabilizimin e operacioneve ekonomike në periudhën e duhur.
 - Pasqyrimin e saktë të operacioneve ekonomike në raportin financiar.
- Bilanci Kontabël është përgatitur në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Ai është i rakorduar me anekset e tij.

e) Veprimet në monedha të huaja

Veprimet në monedhë të huaj janë vlerësuar në lekë duke përdorur kursin e Bankës së Shqipërisë në datën e kryerjes së tyre.

f) Vlerësimi i likuiditeteve

Gjendjet e likuiditeteve në bilancin e datës 31.12.2018 përfshijnë gjendjen e parave në arkë, në llogaritë bankare në lekë dhe në monedha të huaja. Gjendjet e likuiditeteve në monedhë të huaj në datën e mbylljes të bilancit janë vlerësuar në lekë me kursin valutator të Bankës së Shqipërisë së datës 31.12.2018 (ose me vlerën e drejtë). Diferencat kanë kaluar në rezultat.

g) Të ardhurat

Janë rregjistruar në masën e konstatuar gjatë vitit ushtrimor dhe lidhjes që kanë me ushtrimin e mbyllur kontabël.

h) Vlerësimi i kontrollit të brendshëm dhe mbajtja e kontabilitetit

Sipas skemës së organizimit, vlerësues të kontrollit të brendshëm, shoqëria ka Administratorin. Kontabiliteti mbahet nga një financiere që është e punësuar në shoqëri. Pika të forta të kontrollit menaxhues janë politika e centralizuar e çmimeve dhe e kontratave të lidhura me klientët dhe furnitorët. Në kontrollin kontabël janë llogaritë menaxhuese, rakordimet e llogarive të likuiditetit, debi, kredi.

Në shoqëri sigurohet një kontroll reciprok dhe ndarje e pranueshme e funksioneve për t'u kryer nga i njëjti person.

Llogaritë janë transparente e të kuptueshme, me përshkrim të plotë, të qartë dhe pasqyrojnë gjendjen e shoqërisë me sinqeritet.

i) Vijueshmëria e aktivitetit

Vijueshmëria e aktivitetit të biznesit është e garantuar edhe për vitin në vazhdim.

Argumentuar kjo me;

- Emrin e mirë për shërbimet cilësore që ofron
- Shumat që ka për të arkëtuar me të cilat mund të përballojë detyrimet dhe të vazhdojë aktivitetin
- Nuk ka asnjë konflikt gjyqësor me kreditorët
- Është korrekte në marrëdhëniet me shtetin
- Ka siguruar një normë rentabiliteti të mirë

3. ANALIZA E POSTEVE TË BILANCIT

I. Aktivet Afatshkurtra

1. Aktivet Monetare

Likuiditete: Gjendja në bilanc më 31.12.2018 është: 19.539.554 lekë. Kjo është gjendja monetare në arkë dhe në bankë. Politika kontabël e përdorur: Vlera e drejtë. Referencë në SKK: SKK3.

TP



Aktive monetare më 31.12.2018

Përshkrimi	Vlera në lekë
Arka	18.826.064
Banka	(12.769.497)
Garanci Bankare	13.482.991
Totali	19.539.558

Transaksionet bankare dhe të arkës për të gjithë vitin ushtrimor mbështeten në dokumenta justifikues, janë të rregjistruara rregullisht e në kohën e duhur. Tepricat e llogarive kontabël përputhen me ekstraktet e bankës dhe librin e arkës.

Pronësia, mbi gjendjen e parave vërtetohet me titullin nominal të dokumentave kontabël.

Ekzistenca, është konfirmuar nga banka me konfirmën e saj, është e rakorduar me shifrat në ditarin e bankës e arkës dhe përputhet me shifrat e paraqitura në bilanc.

2. Derivate dhe aktive të mbajtura për tregtim. Nuk ka.

3. Aktive të Tjera Financiare Afatshkurtra. Janë në vlerën **88.442.163** lekë. Politika kontabël e përdorur: Vlera e drejtë (nominale) e kërkesës për arkëtim. Referencë në SKK: SKK3.

Kërkesa te arketueshme deri ne nje vit

Përshkrimi	Vlera në lekë
Klientë për të arkëtuar	44.855.433
Klientë për parapagime	21.161.747
Debitorë të tjerë	22.424.983
Totali	88.442.163

Janë pasqyruar të drejtat që ka shoqëria kundrejt të tretëve. Kërkesa të tjera të arketueshme që lidhen me detyrimet që kanë të tretët ndaj shoqërisë (klientë) dhe në lidhje me shtetin (organet tatimore). Vlerësimi i tyre është bërë në përputhje me SKK-të.

4. Inventari

Gjendje inventariale është në vlerën 22.117.829 lekë. Kjo gjendje përbëhet nga materiale për shërbimet që kryhen në punimet e ndërtimit dhe në shërbime të tjera. Referencë në SKK: SKK4.

5. Shpenzime të shtyra 66.780.896 lekë.

6. Aktive biologjike. Nuk ka.

II. Aktivet Afatgjata

1. Investime financiare afatgjata. Nuk ka.

2. Aktive afatgjata materiale. Këto aktive janë skeleri, automjete, makineri e pajisje pune dhe pajisje zyre e informative të paraqitura në vlerë neto pasi janë pakësuar me vlerën e amortizimit të

TP



akumuluar të secilit prej grupeve. Amortizimi është aplikuar në baza të grupimeve të aktiveve me përqindjet fiskale përkatëse. Politika kontabël e përdorur: kosto e blerjes (vlera kontabël) minus amortizim i akumuluar, paraqitet me vleren neto. Referenca në SKK: SKK 5. Gjendja në bilanc është 143.353.922 lekë dhe përbëhet nga:

Nr.	Emërtimi	Vlera fillestare	Shtesa	Pakësime	Amortizim	Vlera mbetur
1	Makineri e pajisje pune (skeleri)	130,580,351	0	(1,000,000)	0	129,580,351
2	Makineri, Pajisje	14,034,939	0	(4,480,986)	0	9,553,953
3	Mjete transporti	26,943,170	0	(26,804,170)	0	139,000
4	Mobilje dhe pajisje zyre	1,962,157	125,000	0	0	2,087,157
5	Pajisje informative	1,595,129	398,332	0	0	1,993,461
	Totali	175,115,746	523,332	(32,285,156)	0	143,353,922

3. Aktive biologjike afatgjata. Nuk ka.

4. Aktive afatgjata jomateriale. Nuk ka.

5. Kapital aksionar të papaguar. Nuk ka.

6. Aktive afatgjata të tjera. Nuk ka.

II. Detyrimet dhe kapitali

I. Detyrime afatshkurtra


1. Derivate. Nuk ka.

2. Huamarrje. Huamarrje afatshkurtër nuk ka.

3. **Huatë dhe parapagimet.** Këtu janë përfshirë detyrimet ndaj furnitorëve, punonjësve, shtetit, debitorëve e kreditorëve të tjerë. Ato janë paraqitur në bilanc për shumën përkatëse që do të paguhet. Politika kontabël e përdorur: Kosto e amortizuar. Referenca në SKK: SKK3.

Detyrime të pagueshme deri në një vit

Numër rendor	Emërtimi	Vlera në lekë
1	Kontribute për sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe paga	7.525.941
2	Detyrime të tjera	38.371.723
3	Të pagueshme për detyrimet tatimore	11.583.831
4	Të pagueshme ndaj furnitorëve	60.603.829
	Totali	118.085.324



Të gjitha detyrimet janë të identifikuar e të pranuar.

4. Grante dhe të ardhura të shtyra. Nuk ka.

5. Provizione afatshkurtra. Nuk ka.

II. DETYRIME AFATGJATA

1. Hua afatgjata. Nuk ka

2. Hua të tjera afatgjata. Nuk ka.

3. Provizione afatgjata. Nuk ka.

4. Grante dhe të ardhura të shtyra. Nuk ka

III. KAPITALI

Kapitali aksionar. Politika kontabël e përdorur: Vlera kontabël e aksioneve.

Nuk ka ndryshime në kapitalin aksionar.

Rezultati i ushtrimit

- Për vitin 2018 rezulton fitimi neto në vlerë 207.571 lekë.

4. ANALIZA E PASQYRËS TË ARDHURA SHPENZIME

Për hartimin e PASH-së është përdorur klasifikimi i shpenzimeve sipas natyrës. Referencë në SKK: SKK 8.

Në zërin "shitje neto", me referencë llogaritë 700-708, janë paraqitur të ardhurat e përfituara nga shërbimet e kryera për të tretë: punime ndërtimi, shitje mallrash dhe shërbime skelerie në vlerën prej 56.887.293 lekë.

Në zërin "materiale të konsumuara," me referencë llogaritë 601-608, janë paraqitur shpenzimet për materiale të para dhe materiale të tjera të konsumuara për punime ndërtimi dhe shërbimi të kryera ndaj palëve të treta në vlerë (42.884.860) lekë.

Në zërin "kosto të punës", me referencë llogaritë 641-648, janë paraqitur shpenzimet për paga punonjësish dhe kontribute për sigurimet shoqërore e shëndetësore në vlerë (12.528.027) lekë.

Në zërin "amortizime e zhvlerësime" me referencë llogaritë 6813-6815, janë paraqitur shpenzimet e amortizimit të AAM-ve të llogaritura në përqindjet përkatëse sipas grupimeve në vlerë (0) lekë si dhe shpenzime të panjohura në vlerë (4.459.622). Në zërin "të ardhura e shpenzime financiare", me referencë llogaritë 767-667, 769-669, janë paraqitur në vlerë neto të ardhurat nga interesat dhe kursi i këmbimit dhe shpenzimet përkatëse për secilën prej tyre.

Fitimi neto i vitit ushtrimor rezulton në vlerën prej 207.571 lekë.

5. ANALIZA E PASQYRËS SË FLUKSIT MONETAR

Për hartimin e pasqyrës së fluksit monetar është përdorur metoda indirekte.



Për të dhëna të tjera subjekti i interesuar mund t'i drejtohet pasqyrave financiare: bilancit kontabël, pasqyrës së të ardhurave e shpenzimeve, pasqyrës së fluksit monetar dhe pasqyrës së lëvizjes së kapitalit.

Administrator
Kastriot Ponari

